



NËNTOR – DHJETOR 2021



TAKIM ME AGJENSINË PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS KOSOVË

Mirëpritëm në ambientet e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas delegacionin e Agjensisë për Ndhmë Juridike Falas, Republika e Kosovës.

Ky takim dypalësh midis dy institucioneve përgjegjëse për ofrimin e ndihmës juridike falas në shtetet respektive bëri të mundur shkëmbimin e eksperiencave midis përfaqësuesve. Disktuam me

Drejtoreshën Ekzekutive zj. Anita Alaj Kalanderi dhe ekipin e saj mbi vendosjen e urave të bashkëpunimit dhe zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta.

Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas gjen rastin të shprehë falenderimet për delegacionin e Kosovës dhe bashkëpunimin e treguar në këtë kuadër.





TAKIM ME FOKUS FUQIZIMIN E KLINIKAVE TË LIGJIT SI OFRUES TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE

Drejtorja e Ndhmës
Juridike Falas me

mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri zhvilloi në Ditën Ndërkombëtare për të
Drejtat e Njeriut tryezën me fokus fuqizimin e Klinikave të Ligjit pranë IAL-ve si ofrues të



ndihmës juridike parësore.

Në këtë takim vlen të evidentojmë pjesëmarrjen e z. Maclean, Shefi në detyrë i Departamentit të Shtetit të së Drejtës dhe të Drejtave të Njeriut, Zj. Vorpsi, Zj. Bano dhe Z. Kosta, të cilët ndanë me pjesëmarrësit eksperiencat e tyre në fushën e së drejtës dhe sidomos në fushën e ndihmës juridike.

Disktuam mbi rolin e Klinikave të Ligjit me përfaqësuesit e Klinikave në kuadër të forcimit të bashkëpunimit, shtrirjen më tej të urave të bashkëpunimit dhe në evidentimin e problematikave dhe mënyrën sesi mund ti zgjidhim ato.

Studentët e pranishëm ndanë eksperiencat e tyre konkrete nga angazhimi i tyre në Klinikat e Ligjit pranë Fakulteteve të Drejtësisë duke treguar raste nga praktika, arritjet e tyre dhe falenderimet për njohuritë e marra.

Kemi bindjen e plotë që përmes këtij takimi të rrisim kapacitetin e Klinikave të Ligjit, pjesë në mekanizmin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, si një mundësi koordinimi midis tyre, me Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas apo me aktorë të tretë;

Dhe më e rëndësishmja, të nxitim studentët e Fakulteteve të Drejtësisë për të qenë pjesë e mekanizmit të ndihmës juridike.

Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas vlerëson maksimalisht angazhimin dhe seriozitetin e Klinikave të Ligjit dhe shpresojmë që gjatë këtij viti të vijojmë me forcimin e bashkëpunimit.



TAKIM ME PARALIGJORËT E ANGAZHUAR

Mirëpritëm në Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas paraligjorët e angazhuar në kuadër të projektit “*Angazhimi pro-aktiv i paraligjorëve në kuadër të rritjes së aksesit të kategorive vulnerabël në shërbimet e ndihmës juridike të garantuar nga shteti*”, të cilët mbyllën me sukses 4 trajnimet e zhvilluara.

Diskutuam mbi përfshirjen e paraligjorëve në ofrimin e ndihmës juridike si një mundësi mjaft e mirë sa i përket identifikimit të komuniteteve në nevojë si dhe vendosjes së një lidhje të drejtpërdrejtë mes qendrave të shërbimit të

ndihmës juridike, organizatave jofitimprurëse dhe institucioneve shtetërore me komunitetin.

Në përfundim, u shpërndanë certifikata për të gjithë pjesëmarrësit.





TAKIM PRANË QENDRËS SË SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE DURRËS

Ditën e djeshme u zhvillua pranë ambienteve të Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Durrës takimi me zj. Petra Oberberger, e cila është menaxhere e programit për Shqipëri dhe Kosovë nga ADA në Vjenë.

Në këtë takim morën pjesë si përfaqësues të DNJF-së zj. Pogace dhe zj. Poci, punonjësit e Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Durrës zj. Zoto dhe z.Jani, përfaqësues nga organizata jofitimprurëse e autorizuar nga Ministri i Drejtësisë “Qendra për Nism Ligjore Qytetare” zj. Shehu dhe përfaqësues të UNDP zj. Cobani dhe zj. Papavangjeli.

Fillimisht u bë një vizitë në ambientet e zyrës së ndihmës juridike ku Zj. Petra u njoh nga afër me procesin e punës së punonjësve me trajnim të posaçëm pranë kësaj zyre.

Më pas u zhvillua takimi i cili kishte në fokus prezantimin e sistemit e ndihmës juridike të garantuar nga shtet



NDIHMA JURIDIKE FALAS NË QYTETIN E BERATIT

Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas ja ka dedikuar muajin Dhjetor edukimit ligjor të qytetarëve mbi sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

Ishim në qytetin e Beratit, ku hodhëm hapat e parë për bashkëpunimin me institucionet e këtij qarku mbi bashkëpunimin me Drejtorinë.


Drejtori i Përgjithshëm nënshkroi një marrëveshje mirëkuptimi me Drejtorinë e Shërbimit Social pranë Bashkisë Berat mbi referimin e rasteve dhe vendosjen e urave të bashkëpunimit.

Zhvilluam një takim të përbashkët me aktorët kryesorë të këtij qyteti, me përfaqësues të Bashkisë Berat, Zyës Arsimore, Prokurorisë, Policisë etj.



INTERVISTË E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM PËR TELEVISIONIN TOP CHANNEL MBI ARRITJET E DREJTORISË SË NDIHMËS JURIDIKE FALAS





REZULTATE TË SISTEMIT TË NDIHMËS JURIDIKE TË GARANTUAR NGA SHTETI NDËR VITE

Ndihma Juridike Parësore – Viti 2021

- 32 ofrues të shërbimit të ndihmës juridike të cilët gjejnë shtrirje në mbi 95 % të territorit të vendit
- 10 (dhjetë) qendra të shërbimit të ndihmës juridike parësore në Tiranë; Durrës; Shkodër; Lezhë; Lushnje; Pogradec; Gjirokastrë; Vlorë; Fier dhe Dibër;
- 12 (dymbëdhjetë) organizata jofitimprurëse të cilat operojnë në Tiranë; Durrës; Elbasan; Berat; Shkodër, të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë
- 11 (njëmbëdhjetë) Marrëveshje Bashkëpunimi me Klinikat Ligjore pranë IAL-ve që operojnë në Tiranë; Vlorë dhe Shkodër.
- Ndihma Juridike Parësore ONLINE (platformajuristionline.al) dhe ndihma juridike në E-Albana.
- Numri i gjelbër pa pagesë 08001010
- Në vitin 2019 kanë përfituar ndihmë juridike parësore 23 qytetarë
- Në vitin 2020 kanë përfituar ndihmë juridike parësore 4191 qytetarë
- Në vitin 2021 kanë përfituar ndihmë juridike parësore 8153 qytetarë.

2019-2021 (12.367 Raste)

REZULTATE TË SISTEMIT TË NDIHMËS JURIDIKE TË GARANTUAR NGA SHTETI NDËR VITE

Ndihma juridike dytësore – Viti 2021

- Mbulim me avokatë, ofrues të ndihmës juridike dytësore në 100% të territorit të RSh sipas qarqeve;
- Nënshkruajnë kontratë me DNJF për ofrimin e ndihmës juridike dytësore 124 avokatë për vitin 2020. Për vitin 2020, kanë rezultuar 73 avokatë pjesë të listës së ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike dytësore;



2019-2021 (1.074 vendime gjyqësore)